



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E SUHAREKËS  
MUNICIPALITY OF SUHAREKA-OPSTINE SUVA REKA



ZYRA E PROKURIMIT

Nr.018/2021

Nr. Protokolli: 25/2021

<b>Për:</b>	<b>Theranda Vets Sh.P.K</b>
<b>Kopje:</b>	z.Bali Muharremaj, Kryetar i Komunës së Suharekës
<b>Nga:</b>	Afrim BYTYQI, u.d. Shef i Prokurimit
<b>Lënda:</b>	<b>VENDIM</b>
<b>Datë:</b>	<b>22.03.2021</b>

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Suharekës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 7 (paragrafi 7.1 pika a ) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës **19.03.2021** të parashtruar nga Operatori Ekonomik: **Theranda Vets Sh.P.K , Rr. Xhavit Sylaj, Suharekë, për Aktivitetin e Prokurimit Trajtimi i qeneve endacak** me Nr. të Prokurimi: **624-20-919-2-2-1 & 624-020-054-221** nxjerr këtë:

**V E N D I M**

- I. Aprovohet Pjesërsht kërkesa për ri-shqyrtim e datës 19.3.2021 te parashtruar nga Operatori Ekonomik Theranda Vets Sh.P.K , Rr. Xhavit Sylaj, Suharekë, për Aktivitetin e Prokurimit Trajtimi i qeneve endacak me Nr. të Prokurimi: 624-20-919-2-2-1 & 624-020-054-221**
- II. Mbetet në fuqi Njoftimi për Kontratë dhe shtyhet afati për dergimin e ofertave / për pjesmarrjen deri me 02.04.2021, ora 14:00, përmes formularit B54.**
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.**

## Ar sy e t i m

Autoriteti Kontraktues, Komuna Suhareke me datë 19.03.2021 ka pranuar kërkesë për ri-shqyrtim nga Operatori Ekonomik **Theranda Vets Sh.P.K , Rr. Xhavit Sylaj, Suharekë** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Trajtimi i qeneve endacak** me Nr. të Prokurimi: **624-20-919-2-2-1 & 624-020-054-221.**

Pas verifikimit të të dhënave në lidhje me pretendimet ankimore të kërkesës për ri-shqyrtim të paraqitura nga ana juaj, ne kemi konstatuar se kërkesa juaj është pjesërisht e bazuar për faktin se AK- nuk ka arritur kthimin e përgjigjes në pyetjet tuaja të kërkesës për sqarime shtes të paraqitur në platformen elektronike me datë 17.03.2021, kjo ka ndodhur për arsye se Komuna e Suharekës në disa njesi është duke punuar në mungesë stafi si pasojë e Pandemis Covid-19, dhe se për pyetjen tuaj të parashtruar nuk kemi arrit që mbrenda dy dite të marrim përgjigjeje nga njesia e kërkesës. Andaj dhe ky vendim aprovohet pjesërisht. Duke u mbështetur në dispozitat ligjore të LPP-së dhe RRUOP, në vazhdim ju parqesim shpjegim për çështje e ngritura:

### **Kushtet teknike që duhet të plotëson operatori për trajtimin e përkohshëm të kafshëve endacake dhe të pa regjistruara**

- a) Qendra për trajtimin e përkohshëm të kafshëve endacake dhe të pa regjistruara duhet të jetë në një vend ku nuk pengojnë punën dhe aktivitetin e objekteve për rreth dhe nuk ndotin mjedisin;
- b) Duhet të jetë së paku 500 metra larg vendbanimit,
- c) Nëse distanca është më pak se 500 metra atëherë duhet të jetë e mbyllur me rrethojë me lartësi të mjaftueshme e cila mund të shihet në mënyrë vizuale dhe të jetë e izoluar nga mjedisi.
- d) Perimetri i qendrës duhet të jetë i mbyllur me një rrethojë e cila është konstruktuar ashtu që të parandaloj hyrjen dhe daljen e kafshëve.
- e) Operatori duhet të ketë sasi të mjaftueshme të ujit të pijshëm nga ujësjellësi publik ose nga burimet vetanake.
- f) Objekti duhet të ketë të vendosur sistemin e menaxhimit të ujërave të zeza dhe ujërave atmosferike të cilat duhet të derdhën në sistemin e kanalizimit publik apo gropë septike.
- g) Objekti duhet të plotësojë kushtet e përgjithshme higjieno -teknike në mënyrë që të mundësohen kushte optimale për vendosjen e kafshëve.
- h) Dyshemetë e qendrës, muret dhe tavanin duhet të ketë të ndërtuara me materiale rezistente dhe të përshtatshme që lehtë pastrohen, lahen dhe dezinfektohen.
- i) Operatori duhet të ketë pajisje ftohëse për ruajtjen dhe transportin e kufomave deri tek vendi i asgjësimit, të cilat duhet rregullisht të pastrohen dhe dezinfektohen.
- j) Operatori duhet të ketë pajisje të përshtatshme si: kafaz transportues, qafore, çantë, ushqim për të joshur kafshët dhe mjete kimike që mund të përdoren për kafshët agresive,
- k) Të ketë hapësirën - vendin me minimum 10 bokse për qëndrimin post operativ të qeneve (5 ditë tek meshkujt dhe 7 ditë tek femrat pas operimit).

### **Hapësirat dhe pajisjet e qendrës për trajtimin e kafshëve**

- a) Hapësirat për pranimin e qeneve të kapur – zën
- b) Hapësirat për ekzaminimin dhe trajtimin mjekësor të kafshëve - *hapësira duhet të jetë e pajisur me tavoline kirurgjike , instrumente kirurgjike dhe pajisjet tjera përgjellëse;*
- c) Hapësirat për ruajtjen dhe mbajtjen e qeneve të zënë - bokset;
- d) Hapësirat izoluese;
- e) Hapësira për kujdesin post-operativ të kafshëve – bokset
- f) Hapësira e mbyllur ku ruhen pajisjet për pastrim dhe dezinfektim;
- g) Hapësira për ruajtjen e ushqimit për kafshë;
- h) Frigorifer për të ruajtur kufomat deri në groposjen e tyre;
- i) Hapësirat e tualetit – WC

j) Kafaze individuale për vendosje të kafshëve të sapo pranura në qendër të madhësive minimum 1.5 x 1.8 metër dhe së paku 20 cm mbi nivelin e tokës.

- Qendra për trajtimin e qenëve endacak duhet të jetë brenda komunës së Suharekës, të dihet adresa e sakt e lokacionit (me fletë poseduese apo kontrat për shfrytëzim të parcelës).

- Qendra për trajtimin e qenëve endacak duhet të ketë minimum 1 veterinar të diplomuar që ka përvojë në kastrimin dhe sterilizimin e qenëve endacak dhe 2 teknik veterinar.

- OE. Duhet të posedoj mjetë dhe pajisje teknike për realizimin e projektit-së paku një eskavator, dy automjete pikap për transport të qenëve, numrat për matriculim-identifikim.

- Qendra për trajtim- Strehim duhet të ketë së paku 10 bokse për qenë.

- duhet të jetë licenca valide e lëshuar nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë për kryerjen e shërbimeve veterinarë në teren.

-Trajtimin për qenë mund të kryejnë:

1. OJQ-Qendrat e Kosovës për strehim dhe trajtim që janë të licencuar nga AUVK.

2. Ambulancat veterinarë të licencuar nga Agjencia e Ushqimit Veterinarisë së Kosovës (AUVK).

Andaj bazuar në të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së.

Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

u.d. Shefi i Prokurimit

Afrim BYTYQI

